



**BASHKIA TIRANË  
QËNDRA KULTURORE TIRANA**

**NJOFTIM ANULLIMI**

**"I PROCEDURËS KËRKESË PËR PROPOZIM"  
OBJEKTI "BLERJE FONIE TË LËVIZSHME".**

Sot më datë 16.06.2017 Autoriteti Kontraktor 'Qendra Kulturore Tirana', pas perfundimit te afatit te ankimit, njofton anulimin e Proçedures se Prokurimit me keto te dhena :

Lloji i proçedures : "Kerkese per Propozim"

Objekti : "Blerje Fonie te Lëvizshme"

Fondi limit me vlerë : 4.148.813 ( kater milion e njeqind e dyzete e tete mije e teteqind e trembedhete ) lekë pa TVSH.

Anullimi kryhet ne mbeshtetje të nenit 24 pika 1 germa 'ç' te Ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, me arsyetimin se nga perfundimi i vleresimit te ofertave te paraqitura nga dy operatoret ekonomike (1.La Boheme dhe 2.Pro Sound), rezultoi se te dy keta operatore nuk u kualifikuan pasi nuk permbushen kriteret e percaktuara ne DST. Konkretisht :

**1. LA BOHEME**

Ky operator ekonomik me adresë : Rruga e Elbasanit, Qendra e Biznesit Nr. 204, Tiranë dhe NUIS K41919004J, ka dorëzuar dokumentat brenda afatit të vendosur nga Njesia e Hartimit te Dokumentave në DST e publikuara në APP, si më poshtë :

Çmimi total i ofertës pa TVSH është 3.750.000 (tre milion e shtateqind e pesedhete mije) leke

Çmimi total i ofertës me TVSH është 4.500.000 (kater milion e peseqind mije) leke

Nuk ka pasur tërheqje apo modifikim ofertash nga kjo shoqëri.

Nga Operatori Ekonomik nuk plotesohen kerkesat :

1. Nuk eshte paraqitur Çertifikate ISO 9001, sipas percaktimeve te bera ne Kriteret e Vecanta te Kualifikimit te DST-ve.

2. Nuk janë paraqitur Çertifikimet TUV për produkte, Skeleri alumini trekendore 3m, Skeleri alumini trekendore 1.5m, sipas percaktimeve të bera në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Specifikimet Teknike të DST-ve.

3. Nuk janë paraqitur Çertifikimet CE për produkte, Boks aktiv line array 1700 watt, Subwoofer line array aktiv 1500 watt, Podium me permasa 2 x 1m dhe kapacitet 500 kg/m katror, Panel korenti me hyrje 32 Amper dhe dalje me 12 shuko të ndara 4 për çdo fazë, sipas percaktimeve të bera në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Specifikimet Teknike të DST-ve.

Bazuar në Ligjin nr. 9643, dt. 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Udhezimit nr.03 datë 09.05.2017 "Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në Sistemin e Prokurimit Elektronik" në perfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, KVO vendosi:

1. Të mos pranojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik LA BOHEME shpk
2. Të mos kualifikojë ofertën e tij.

Në zbatim të nenit 53 pika 5/a të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe dokumentave standarde, Komisioni vendosi se oferta është e pavlefshme, pasi i nuk i plotëson kërkesat ligjore.

## **2. PRO SOUND**

Ky operator ekonomik me adresë : Rruga e Kavajes, ish-Misto Mame, Zona Kadastrale 8240, Tiranë dhe NUIS K62320012O, ka dorëzuar dokumentat brenda afatit të vendosur nga NJHD në DST e publikuara në APP, si më poshtë:

Çmimi total i ofertës pa TVSH është 4.067.000 (kater milion e gjashtedhjetë e shtatë mijë) leke

Çmimi total i ofertës me TVSH është 4.880.400 (kater milion e teteqind e tetëdhjetë mijë e katerqind) leke

Nuk ka pasur tërheqje apo modifikim ofertash nga kjo shoqëri.

Nga Operatori Ekonomik nuk plotësohen kërkesat :

1. Një dokument që vërteton se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore , të lëshuar nga Administrata Tatimore, percaktuar në Kriteret e Pergjithshme të Kualifikimit të DST-ve. Operatori ka paraqitur një vërtetim nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve ku rezulton me gjore në vlerën 500.000 leke për mospagim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shendetesore.

2. Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, percaktuar në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST-ve. Operatori ka paraqitur

nje vertetim ku vertetohet se per muajin Mars 2017 nuk jane paguar detyrimet perkatese te energjise elektrike.

Bazuar në Ligjin nr. 9643, dt. 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Udhezimit nr.03 date 09.05.2017 "Për shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave ne Sistemin e Prokurimit Elektronik" ne perfundim te shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, KVO vendosi:

1. Te mos pranoje oferten e paraqitur nga operatori ekonomik PROSOUND.
2. Te mos kualifikoje oferten e tij.

Në zbatim te nenit 53 pika 5/a të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe dokumentave standarde, Komisioni vendosi se oferta është e pavlefshme, pasi i nuk i ploteson kërkesat ligjore.

Vleresimi dhe kualifikimi i nje operatori ekonomik kryhet kundrejt te gjitha kerkesave te kualifikimit te kerkuara ne dokumentat standarde te tenderit. Komisioni i Vleresimit te Ofertave eshte bazuar ne nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve", ne nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave" dhe ne nenin 55 "Kriteret e percaktimit te ofertes fituese" te Ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar, per skualifikimin e te dy operatoreve ekonomike te paraqitur.

**KRYETARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**Drejtori**  
**Jonida BEQO**